

GJUHË SHQIPE DHE LETËRSI



QENDRA
E PROVIMEVE



KONTROLLIMI EKSTERN I DIJES SË NXËNËSVE NË FUND TË CIKLIT TË TRETË TË SHKOLLËS FILLORE

UDHËZIM

KOHA PËR ZGJIDHJEN E TESTIT ËSHTË 70 MINUTA.

Mos e hap testin dhe mos fillo t'i zgjidhësh detyrat para se të japë leje mësimmshënësi kujdestar.

Testi **DUHET** të jetë i shkruar me laps kimik ose me stilolaps.

Shkruaj lexueshëm dhe me shkronja dore.

Nëse shkruan me shkronja shtypi, thekso shkronjën e madhe atje ku duhet të jetë. Respekto rregullat gramatikore dhe drejtshkrimore. Nëse mendon se ke gabuar në zgjidhjen e detyrës, vendos një vijë të kryqëzuar (X) mbi të dhe zgjidhe përsëri.

Nuk guxon ta përdorësh korrektorin.

Detyrat nuk e ke për detyrë t'i zgjidhësh me rend ashtu siç janë dhënë në test. Nëse e përfundon punën më parë, kontrolloji edhe një herë zgjidhjet tua.

Detyra do të vlerësohet me zero pikë nëse:

- ▶ është e pasaktë
- ▶ është e palexueshme dhe nuk është e qartë
- ▶ është e shkruar me laps grafit/të thjeshtë
- ▶ është shkruar ose rrethuar edhe përgjigjja e saktë dhe e pasaktë

ME FAT!

SHIFRA E NXËNËSIT

QERSHOR, VITIT MËSIMOR 2024-2025

FAQJA E ZBRAZËT

Lexo tekstin *Si quhej njeriu i parë në histori?*, pastaj përgjigju në pyetjet 1, 2, 3, 4 dhe 5.

SI QUHEJ NJERIU I PARË NË HISTORI?

TË DHËNAT MË TË HERSHME TË PARAARDHËSVE TANË DUKEN KËSHITU:



Kjo pllakë prej argjile është shkruar në qytetin Uruk më shumë se pesë mijë vjet më parë. Në të shkruan: 135.000 litra elb 37 muaj Kushim. Çfarë mendon se do të thotë kjo?

Duket se një farë Kushim me këtë ka konfirmuar se ka marrë një sasi prej 135.000 litra elb për një periudhë 37 mujore. Nëse ky Kushim ishte një person real, atëherë ai është njeriu i parë në histori, emrin e të cilit ia dimë! Është interesante se emri i parë i regjistruar në historinë njerëzore nuk ishte emri i një udhëheqësi të madh ushtarak, poeti apo profeti, por i një nëpunësi të zakonshëm që i kalonte ditët duke numëruar drithërat. Tekstet e para të shkruara nuk ishin reflektime të thella filozofike, as poema, as tregime për mbretërit dhe perënditë. Ato ishin të dhëna të mërzitshme kontabël që listonin pronarët, asetet dhe borxhet tatimore. Nuk duhet të na habisë fakti që këto tekste janë të mërzitshme, sepse ajo që ishte interesante dhe emocionuese nuk duhej të shkruhej – njerëzit i mbanin mend ato. Alfabeti u shpik për gjëra të mërzitshme.

Historia se pse u shpik shkrimi është përgjigja vetëm për një nga shumë pyetjet e rëndësishme të adresuara nga historiani dhe filozofi i famshëm Juval Noa Harari, autor i bestsellerit botëror *Sapiens*, në librat e tij nga seria *Ne të pandalshmit*. Seriali është i destinuar për adoleshentët më të rinj dhe, sipas planit, duhet të përfshijë katër libra. Në librin e parë – *Si e pushtuam botën* – lexuesit mësuhan sesi njerëzit, falë zbulimit të zjarrit, shoqërimit dhe besimit në historitë e përbashkëta, u bënë speciet më të fuqishme në planetin Tokë. Pjesa e dytë – *Pse bota nuk është e drejtë* – u botua së fundmi dhe tashmë është futur në listën e bestsellerëve të *New York Times*. Harari e nis rrëfimin duke përshkruar procesin e kalimit nga një grumbullim në një mënyrë jetese bujqësore, që i solli njerëzimit shumë pengesa dhe probleme.

Fija që lidh të dy librat është theksi mbi superfuqinë njerëzore – aftësinë për të treguar histori. Individët bashkohen rreth historive dhe veprojnë së bashku në shoqëritë e tyre. Qofshin ato nga mitologjia, feja, përrallat, politika shtetërore apo mësimet e historisë në shkollë, këmbëngulja e vazhdueshme e Hararit për fuqinë e tregimeve për të ndikuar në krijimin e një bote më të mirë, por edhe më të shëmtuar, fton audiencën e re të lexojë në mënyrë kritike librat e tij, si dhe të gjitha përmbajtjet e tjera narrative.

Edhe pse, para së gjithash, janë të destinuara për adoleshentët më të rinj, këta libra emocionues dhe autentikë do t'i shijojnë të gjithë lexuesit me një frymë hulumtuese dhe një pamje kritike të botës. Librat e Hararit janë përkthyer në 65 gjuhë dhe janë shitur në 40 milionë kopje, dhe ai konsiderohet si një nga intelektualët më me ndikim të kohës sonë.

(përgatitur sipas www.detinarije.com/category/obrazovanje/biblioteka)

1.

Njeriu i parë emri i të cilit u regjistrua në historinë e njerëzimit ishte:

- 1.** prijës ushtrie
- 2.** nëpunës
- 3.** poet
- 4.** profet

Rretho numrin para përgjigjes së saktë.

1 pikë

2.

Alfabeti u shpik për shkak të gjërave të mërzitshme.

Argumentoje pohimin e mësipërm duke iu referuar tekstit.

1 pikë

3.

Në cilët libra shkruan autori Juval Noe Harari se pse u shpik alfabeti i parë?

1 pikë

4.

Nëse konstatimi është i saktë, rretho S, ndërsa nëse është i pasaktë, rretho P.

Hararijeve knjige su isključivo namijenjene mlađim tinejdžerima.	S	P
Prvo zabilježeno ime čovjeka u istoriji čovječanstva bilo je Kušim.	S	P
Čovjekova supermoć je sposobnost pričanja priča.	S	P
Čitaoci mogu očekivati nastavak serijala <i>Mi nezaustavljivi</i> .	S	P

1 pikë

5.

Shëno dy fakte që flasin për popullaritetin e librave të autorit Juval Noa Harari.

2 pikë

6.

Plotëso tabelën me të dhënat që mungojnë.

Vepra letrare	Autori	Personazhi
		Vuk Mandushiqi
Tom Sojeri		

2 pikë

Lexo fragmentin nga teksti *Gjerdani*, pastaj përgjigju në pyetjet 7, 8, 9 dhe 10.

Zonja Loazel, gruaja e një nëpunësi në Ministrinë e Arsimit, e bukur dhe simpatike, lakmonte një jetë luksoze dhe ballot. I shoqi, duke e ditur këtë, i kërkon ftesë për një pritje me ministrin e Arsimit dhe bashkëshorten e tij. Për këtë rast, zonja Loazel blen një fustan dhe merr hua një gjerdan diamanti nga shoqja e saj, Zonja Forestie. Në pritje shkëlqeu zonja Loazel dhe tërhoqi vëmendjen e të pranishmëve.

1. (...) Ata shkuan me makinë në shtëpi në Rugën e Dëshmorit dhe me trishtim u ngjitën në banesë. Për të, gjithçka kishte marrë fund. Dhe mendoi se nesër në orën dhjetë duhej të shkonte në ministri.

Përpara pasqyrës ajo hoqi mantelin që e kishte hedhë mbi krahët për ta parë veten edhe një herë me gjithë bukurinë e saj. Por papritmas ajo bërtiti. Ajo nuk e kishte më gjerdanin e diamantit në qafë.

Burri i saj ishte gjysmë i zhveshur, ai e pyeti: – Çfarë ke?

Ajo u kthye nga ai, e shqetësuar:

– Unë... unë... nuk ka gjerdan diamanti nga zonja Forestie. (...)

2. Kur zonja Loazel ia çoi gjerdanin zonjës Forestie, kjo e fundit, duke u ndjerë pak e ofenduar, tha: „Duhet ta kishe kthyer më shpejt, mund ta kisha përdorur“. Ajo nuk e hapi as kutinë, të cilës i kishte frikë shoqja. Çfarë do të mendonte ajo nëse do të vinte re se i kishte vendosur një gjerdan tjetër? A nuk do ta konsideronte atë një hajdute?

Dhe zonja Loazel ndjeu sa e tmerrshme ishte jeta e të varfërve. Por ajo papritmas pajtohet heroikisht me të. E pushuan shërbëtoreshen, ndërruar banesën, morën me qira një apartament në papafingo. Ajo bënte punë të rënda shtëpie... Çdo muaj duhej të rregullonin kambialet dhe të firmosnin të rejat që të fitonin në kohë... Në fund të vitit të dhjetë i paguan të gjitha, gjithçka, bashkë me kamatat e fajdexhinjve mbi kamatë.

3. Tani zonja Loazel dukej si një grua e moshuar. (...) E krehur keq, me fundet e lidhura shtrembër dhe me duar të kuqe, fliste me zë të lartë dhe lante enët me ujë të nxehtë. Por ndonjëherë, kur i shoqi ishte në zyrë, ajo ulej pranë dritares dhe mendonte për mbledhjet e mbrëmjes së dikurshme, për ato ballo kur ajo kishte qenë kaq e bukur dhe aq shumë e vlerësuar. Çfarë do të kishte ndodhur nëse ajo nuk do ta kishte humbur atë gjerdan? Kush e di! Kush e di! Sa e çuditshme, e ndryshueshme është jeta! Sa pak i duhet një njeriu që të humbasë apo të shpëtohet!

4. Një të diel, kur ajo doli për një shëtitje në fushat e Elizesë për të bërë një pushim nga puna e saj gjatë javës, papritmas pa një grua duke marrë një fëmijë për shëtitje. Ishte zonja Forestie, gjithmonë e re, gjithmonë e bukur, gjithmonë tërheqëse. Zonja Loazel u emocionua. A duhet të flasë me të? Po, sigurisht. Dhe tani, kur ajo i kishte paguar të gjitha, do t'i tregonte gjithçka. Pse jo? Ajo iu afrua asaj.

Shoqja e saj nuk e njohu dhe u habit që ajo amvise po i drejtohej në mënyrë kaq miqësore. Ajo belbëzoi:

– Por..., zonjë..., Unë nuk e bëra... Ju padyshim që keni gabuar.

– Nuk e bëra. Unë jam Matilda Loazel.

Shoqja e saj bërtiti:

– O... Matilda ime e mjerë, sa ke ndryshuar!

– Po kam ndryshuar. Kam pasur ditë shumë të vështira që kur të pashë për herë të fundit dhe shumë telashe... dhe të gjitha për shkakun tënd! E mban mend atë gjerdanin e diamantit që më ke huazuar për ballo në ministri?

– Më kujtohet. Pra?

– Epo, e humba. Unë ju solla një tjetër, ashtu si ai. (...)

Shumë e emocionuar, zonja Forestie e kapi nga të dyja duart.

– E mjera Matilda ime! Ato diamante në gjerdanin tim ishin të rrejshme. Nuk vlente më shumë se pesëqind franga.

Gi de Mopasan

7.

Personazhi kryesor në tekst është zonja Loazel. Rretho numrin përpara përshkrimit që vlen për të.

1. dembele dhe e etur për një jetë luksoze
2. indiferente dhe e rraskapitur nga puna e vështirë
3. pajtuese dhe krenare

1 pikë

8.

Në këtë tregim humbëse është zonja Loazel.

Argumentoje qëndrimin tënd në lidhje me pohimin e dhënë duke treguar jetën e zonjës Loazel para dhe pas humbjes së gjerdanit.

2 pikë

9.

Nga pjesa 3 e tekstit, përshkruaje citatin që mund të jetë ideja/porosia e tekstit.

1 pikë

10.

A) Cilës gjini letrare i përket teksti?

1 pikë

B) Shkrimtari përdor forma të ndryshme të rrëfimit në tekst. Lexo pjesën 3 të tekstit dhe nënvizo fjalinë ku përdoret një detaj për të përshkruar personazhin.

1 pikë

Lexo vargjet në vazhdim dhe zgjidhi detyrat 11, 12 dhe 13.

Kshtu ka marrë e ligjiron:
Anima, moj Orë e Zana,
Tringën ju fort me ma dashtë,
Me ma dashtë, n' kujdes me e pasë:
Me ma ruajt si syt e ballit,
Kurdoherë t' dalë me verue
Ndër kto vise t' Vizitorit,
Qi ktë shtriga t'mos ma ngasë,
Syni i keq t'mos ma peçasë,
N'moh n' mni kamba t' mos m'i shklasë:
Larg "gojlidhnin" me m'ia mbajte
Zhegut t' ditës me m'i ba hije,
Me m'ia ba ju dimnin verë;
Me ma rujtë të njethtë përherë,
Si ato lule në prandverë,
Mbasi lule e flaka Zoti

11. Figura stilistike e përdorur në vargun e pestë është:

1. metafora
2. hiperbola
3. krahasimi
4. personifikimi

Rretho numrin para përgjigjes së saktë.

1 pikë

12. Në këtë fragment të poezisë gërshetohet elementi fantastik me atë real. Si paraqitet elementi fantastik?

1 pikë

13. Autori shpesh mendimin e filluar në një varg e vazhdon në vargun tjetër. Si quhet ky mjet letrar përmes të cilit bëhet ky realizim?

1 pikë

14. Nëse është theksuar vetia tipike për gjuhën e folur, në vijë pranë saj shkruaj "F", kurse nëse është tipike për gjuhën e shkruar, shkruaj "SH":

Realizohet në dialog.

Është formal (zyrtar).

Plotësohet me gjeste dhe me mimikë.

Fjalitë i ka më të gjata dhe më të ndërlikuara.

1 pikë

15. Nga fjalët e mëposhtme ndani fonemat zanore dhe fonemat bashkëtingëllore.

Fonemat zanore te fjalët: arë, erë, orë, syri.

Fonemat bashkëtingëllore: bëj, copë, derë, rrotë, xham

2 pikë

16. Foljet në kllapa përdori në kohën e kryer të thjeshtë:

Taulanti _____ dy bileta për ndeshjen e futbollit.
(blej)

_____ për të shëtitur nëpër rrugët e qytetit.
(Dal)

Ata i _____ shokët kur i _____ në rrugë.
(përsëndes) (takoj)

Ne _____ nga shkolla në orën 12.
(nisem)

Ai _____ shumë herët në mëngjes.
(zgjohem)

2 pikë

17. A) Plotëso fjalinë me fjalën gjegjëse nga kllapat.

Në mbrëmje e _____ çantën për në mëngjes.
(përgadis/përgatis)

1 pikë

B) Shkruaj shkurtesat e fjalëve:

e të tjera _____; për shembull _____.

1 pikë

18. Rishkruaji fjalitë duke i kushtuar vëmendje rregullave të drejtshkrimit.

A) Lexo tekstin nga faqja 15 – 39.

1 pikë

B) Sot kemi mësuar për luftën e dytë botërore.

1 pikë

19. Nënvizojë fjalën e shkruar saktë.

batanie – batanije

1 pikë

20.

- ▶ shkruaj për (jo)popullaritetin e lojërave popullore sot
- ▶ përshkruaje lojën tënde popullore të preferuar (rregullat, numrin e lojtarëve, qëllimin , nëse luhet në internet ose drejtpërdrejtë...)

- shkruaj me kë të pëlqen të luash më së shumti dhe përse

- përshkruaje se si ndihesh gjatë lojës kur humb ose fiton

- shprehe qëndrimin tënd për ndikimin e kësaj loje në jetën tënde të përditshme

18 pikë

PLANI PËR SHKRIMIN E HARTIMIT (nuk është i detyrueshëm)

This image shows a single sheet of white paper with horizontal ruling lines. The lines are evenly spaced and run across the width of the page. There is no text or other markings on the paper.

Handwriting practice lines consisting of 30 horizontal lines.

Handwriting practice lines on page 13.

This image shows a full page of blank handwriting practice paper. It features approximately 30 horizontal grey lines spaced evenly down the page. There are no margins, text, or other markings present.

VETËM PËR VLERËSUESIT

FORMULARI PËR VLERËSIMIN E HARTIMIT NË VITIN MËSIMOR 2024-2025

DETYRA 20

NUMRI I FJALËVE: _____

PËRMBAJTJA

GJUHA DHE FORMA E TEKSTIT

	0	1	2		0	1	2
kërkesa 1	☐	☐	☐	LESIKU	☐	☐	☐
kërkesa 2	☐	☐	☐	GRAMATIKA	☐	☐	☐
kërkesa 3	☐	☐	☐	DREJTSHKRIMI	☐	☐	☐
kërkesa 4	☐	☐	☐	LIDHSHMËRIA	☐	☐	
kërkesa 5	☐	☐	☐	FORMA E TEKSTIT	☐	☐	



E PLOTËSON KOMISIONI PËR VLERËSIM

Numri i përgjithshëm i pikëve të fituara në test:

Nota: _____

KOMISIONI:

VLERËSUESI KRYESOR:

Data _____ 20____